



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:108007
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05727631

Ac.nr.5082/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani e Besnik Feka - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike jo kontestimore të paditësit M.M nga Komuna e P,, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.Q avokat në Gj,,, kundër të paditurave Komuna e Gjilanit të cilën e përfaqëson B.D dhe Komuna e Parteshit të cilën e përfaqëson RR.L, me objekt kontesti kompensimin e të ardhurave personale, vlera e kontestit ,, euro, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - departamenti i përgjithshëm, C.nr.593/2016, të datës 24.02.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datën **23.05.2024** mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË e palejueshme (paafatshme) ankesa e paditësit M.M nga Komuna e P,,, e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - departamenti i përgjithshëm, C.nr.593/2016, të datës 24.02.2021.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.593/2016, të datës 24.02.2021, në pikën I (një) të dispozitivit e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit M.M nga Komuna e P,,, me të cilën ka kërkuar “që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit që paditësit t’ia paguaj të ardhurat personale të papaguara për periudhën kohore prej 01.10.2006 deri më datën 31.12.2010 dhe atë: pagat neto në lartësi prej 13,522.37 euro, dhe kamatën për periudhën kohore prej datës 30.07.2008, deri më datën 31.12.2018, në lartësi prej 3,707.44 euro, gjithësejt 17,229.81 euro, kontributet pensionale prej 1,471.07 euro, dhe tatimin në pagat e cekura që arrin shumën prej 452.82 euro, si dhe të detyrohet Komuna e Parteshit që paditësit t’ia paguaj të ardhurat personale të papaguara për periudhën kohore prej 01.01.2011

deri më 31.08.2014 dhe atë: pagat neto në lartësi prej 14,568.48 euro dhe kamatën për periudhën kohore prej 01.01.2011 deri më 31.12.2018, në lartësi prej 1,605.97 euro, gjithsejtë 16,174.46 euro, kontributin pensional që arrin shumën prej 1,600.42 euro, dhe tatimin në pagat e cekura që arrin shumën prej 635.562, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshëm prej 2,600.00 euro, si të pabazuar. Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka detyruar paditësin Milutin Mitroviq, që të paditurës Komuna e Parteshit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 624 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi, përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të *shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që të aprovohet ankesa e tij dhe të ndryshohet aktgjykimi i atakuar, ashtu që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, ose të njëjtin ta prish dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

E paditura e parë, Komuna e Gjilanit, ka parashtruar përgjigje në ankesë me të cilën ka kërkuar që ankesa e paditësit të refuzohet dhe aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa i paditësit është e paafatshme.

Gjykata e Apelit pasi e shqyrtoi ankesën e paditësit vlerësoi se sipas dispozitës së nenit 186 par.2 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se *“Ankesa është e paafatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”* ndërsa me dispozitën e nenit 196 të LPK-së, parashihet se *“Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë, me aktvendim, po që së nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç parashihet me nenin 186”*.

Në këtë rast Gjykata e Apelit në kuptim të dispozitës së nenit 196 lidhur me nenin 186 par.2 të LPK-së, gjeti se ankesa e paraqitur nga paditësi përkatësisht i autorizuari i paditësit është e paafatshme, pasi që me shikimin në fletë-kthesën për dorëzim personal, vërtetoi faktin se i autorizuari i paditësit aktgjykimin e atakuar C.nr.593/2016, të datës 24.02.2021, e ka pranuar me datë 19.04.2021. Në anën tjetër, ankesa ndaj këtij aktgjykimi është dorëzuar në Gjykatë me datë 05.05.2021, e cila shihet nga vula e pranimi të gjykatës, e vendosur në ankesë. Nga shkresat e lëndës shihet se i autorizuarit i paditësit e ka pranuar edhe aktgjykimin e atakuar C.nr.593/2016, të datës 24.02.2021 në gjuhën serbe me datën 21.06.2021, mirëpo ankesën e ka ushtruar pasi që e ka pranuar aktgjykimin në gjuhën serbe. Ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë shkresë tjetër, përmes së cilës do të konfirmohej se ankesa ndaj aktgjykimit të atakuar është dorëzuar edhe në ndonjë mënyrë tjetër siç parashihet në nenin 103 të LPK-së.

Pasi që afati për ankesë kundër aktgjykimit apo aktvendimit për kontestet nga marrëdhënia e punës sipas dispozitës së nenit 477 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është 7 ditë nga dita e pranimi të vendimit (*i cili afat i është dhënë në udhëzimin juridik të aktgjykimit të atakuar*), atëherë rezulton që ankesa është dorëzuar pas skadimit të afatit ligjor prej (7) ditësh. Kjo për faktin se në rastin konkret afati ka filluar të llogaritet nga data 20.04.2021 (*dita e parë pas ditës së pranimi të aktgjykimit nga përfaqësuesi i autorizuar i paditësit*), ndërsa kur llogariten 7 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë data 26.04.2021, ndërsa paditësi, përkatësisht i autorizuari i tij, ankesën e ka paraqitur me datën 05.05.2021, që rezulton se ankesa është paraqitur me vonesë prej 9 (nëntë) ditë.

Nga sa u tha me sipër, Gjykata e Apelit e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që gjeti së ankesa e paditësit është e pa afatshme, të cilën kjo gjykatë e hudhi poshtë në pajtim me nenin 186.2, 195.1 pika a), e lidhur me nenin 196 të LPK-së, (*edhe pse këtë është dashur dhe ka mundur ta bëjë gjykata e shkallës së parë*).

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5082/2021, datë 23.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Arsim Hamzaj